Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrate
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 613/01-37308
Data/Datum 02.10.2019
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Komuna e Gjakovës

1475
02.10.2019

KRM "ÇABRATI"

# MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM

E lidhur me dt.30.09.2019 ndërmjet palëve:

1. Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i kësaj Komune z. Ardian Gjini, në tekstin vijues theksohet: Komuna.

2. Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "ÇABRATI", të cilën e përfaqëson z. Berat Hadri, Kryeshef Ekzekutiv i KRM "ÇABRATI", në tekstin vijues theksohet: "ÇABRATI".

**Neni 1**

Lëndë e kësaj Marrëveshjeje të bashkëfinancimit është investimi i përbashkët i Komunës së Gjakovës dhe KRM "Çabrati", për blerjen e një kamjonete për mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme.

**Neni 2**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është blerja e një kamjonete për plotësimin e nevojave të KRM "Çabrati" për bartjen e mbeturinave të riciklueshme.

**Neni 3**

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje pajtohen që vlera e afërt e shpenzimit duhet të jetë 9,800€ dhe mjetet financiare duhet të sigurohen nga Komuna e Gjakovës me participim 49% në vitin 2020 dhe KRM "Çabrati" 51 %, procedurat e prokurimit do të zhvillohen nga KRM Çabrati.

**Neni 4**

Palët deklarojnë se mosmarrëveshjet eventuale lidhur me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, do të tentojnë që ti zgjidhin përmes angazhimeve të zyrtarëve të institucioneve pjesëmarrëse në marrëveshje, ndërsa çështjet të cilat mbeten kontestuese, të zgjidhen në Gjykatën kompetente.

**P A L Ë T**

| | |
|---|---|
| **Komuna e Gjakovës** | **KRM Çabrati** |
| **Ardian Gjini** | **Berat Hadri** |